



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës për Kapitullin 24 - Drejtësi, Liri, Siguri

Bashkëpunimi Polici-Media: Liria e Shprehjes dhe Siguria Publike në Procesin e Integrimit European

10 qershor 2026

Xheko Imperial Hotel

11:00 - 12:30

Policia e Shtetit dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në takimin e radhës të Grupit të Punës për Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria Siguria, të organizuar në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin European mbështetur nga Bashkimi European. Takimi do të zhvillohet më 10 qershor 2026, duke filluar nga ora 11:00, në Gold Orchid, Xheko Imperial Hotel.

Grupi i Punës për Kapitullin 24 ofron një hapësirë për konsultim dhe dialog, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave me BE-në, si përfaqësues nga shoqëria civile, akademja, profesionistë të ligjit dhe grupe të tjera interesi. Sesioni synon të informojë, por edhe të sigurojë që shoqëria civile dhe grupet e interesit të mund të japin rekomandime, të ofrojnë reagime mbi kuadrin ligjor, dhe të monitorojnë në mënyrë aktive hartimin e politikave në të gjitha fazat.

Marrëdhënia ndërmjet Policisë së Shtetit dhe medias gjatë protestave dhe ngjarjeve publike përbën një fushë të ndjeshme ku ndërthuren standardet e të drejtave të njeriut me kërkesat për siguri publike dhe rend. Vitin e fundit në kuadër të masave për mbrojtjen e gazetarëve dhe forcimit të marrëdhënies media-polici është përgatitur një udhëzues që është një zhvillim pozitiv, por që kërkon që masat e parashikuara dhe objektivat të realizohen dhe plotësohen. Në këtë kontekst, diskutimi synon të kontribuojë në forcimin e kuptimit të përbashkët mbi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, në përputhje me standardet e BE-së në fushën e lirisë së shprehjes dhe menaxhimit të rendit publik, nevojën për ngritjen e kapaciteteve të forcave të ligjit për respektimin dhe menaxhimin e situatave në mbrojtje të gazetarëve, Takimi do të bëjë bashkë përfaqësues të Policisë së Shtetit, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të medias dhe ekspertë të të drejtave të njeriut, për të diskutuar sfidat aktuale në kuadrin ligjor dhe institucional të Shqipërisë lidhur me marrëdhënien ndërmjet institucioneve të rendit dhe medias me fokus të veçantë protestat dhe tubimet publike.

Diskutimi do të fokusohet në balancën ndërmjet lirisë së shprehjes dhe sigurisë publike, mbrojtjen e gazetarëve gjatë raportimit në terren, rritjen e bashkëpunimit polici-media, si dhe standardet për aksesin dhe sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve publike, në përputhje dhe me standardet e BE dhe praktikën gjyqësore europiane që do të ndahen me pjesëmarrësit nga ekspertë europianë.

Mirëprisnim pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë diskutim.
Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@em-al.org

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit European dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).





Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës për Kapitullin 24 - Drejtësi, Liri, Siguri

Bashkëpunimi Polici-Media: Liria e Shprehjes dhe Siguria Publike në Procesin e Integrimit Evropian

10 qershor 2026	Xheko Imperial Hotel	11:00 - 12:30
11:00 - 11:10	REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE	
11:10 - 11:20	PËRSHËNDETJA E TAKIMIT Gentian Mullai , Koordinator për Informimin Publik, Policia e Shtetit Gledis Gjipali , Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)	
11:20 - 11:40	KAPACITETET E POLICISË DHE MBROJTJA E GAZETARËVE NË TERREN DHE SITUATA RREZIKU - Rritja e kapaciteteve të për trajtimin e incidenteve me gazetarët, përfshirë rastet gjatë protestave dhe tubimeve publike - Garantimi i respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut në ndërveprimin polici-gazetarë - Zbatimi i udhëzimeve për trajtimin e rasteve me median - Përmirësimi i mekanizmave të mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi incidentet që prekin gazetarët - Programet e ngritjes së kapaciteteve për punonjësit e policisë mbi lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve Miranda Boshnjaku , Drejtorja e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor	
11:40 - 12:00	MBROJTJA E GAZETARËVE NË KONTEKSTIN E RENDIT PUBLIK: STANDARDET & PRAKTIKAT E BE - Standardet europiane për sigurinë e gazetarëve në tubime publike - Modele të bashkëpunimit midis medias dhe autoriteteve në BE - Përgjegjësia në rastet e incidenteve që përfshijnë gazetarë - Trajnime dhe qasje parandaluese në vend të reagimit pas incidentit - Mësime të nxjerra nga përvojat e vendeve të BE-së në menaxhimin e protestave dhe raportimit mediatik Pauline Adès-Mével , Gazetare, trajnere dhe eksperte për sigurinë e gazetarëve, ish-kryeredaktore dhe zëdhënëse e Gazetarëve Pa Kufij	
12:00 - 12:20	DISKUTIM I HAPUR	
12:20 - 12:30	MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL	

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

